

Ilion Lika: Me Kastriotin deri ne Qershor!

nga AlbaniaSoccer

E premte, 06 Dhjetor 2013 07:20



Portieri i Kastriotit, Ilion Lika ka hedhur poshte zerat se ne janar do t'i ri bashkohet skuadres se Tiranes. Nje fakt te tille e ben te ditur per www.AlbaniaSoccer.com vete futbollisti. Portieri kryeqyetas i ka mohuar mundesine e kalimit tetij ne nje klubtjeter ne Janar edhe pse akoma nuk eshte kontaktuar ose nuk eshte informuar per ndonje interesim te klubeve te Kategorise Superiore. "Per momentin, Kastrioti eshte e vetmja skuader qe m. Jam pjese e kesaj skuadre dhe mendoj vetem per te mbrojtur porten e Kastriotit", theksoi ish portiere i kombetares. Duke folur per ndeshjen ndaj Beses qe do te zhvillohet kete fund jave ne Kavaje , gardiani i portes krutane u shpreh: "Parashikohet te jete nje ndeshje e forte. Fitorja fundjaven e kaluar dhe barazimi i arritur ne transferen e Ballshit per kupe na e ka rritur dukshem optimizmin. Kam mendimin se nuk do te dalim pa pike nga kjo ndeshje", vijoi Lika.